



# TRAJTIMET

## NDËRHYRJA KIRURGIKALE

- Trajtimi parësor ose vendimtar për shumicën e kancerave të vezores
- Kryhet gjithmonë nga një onkolog gjinekologjik
- Objektivat e ndërhyrjes kirurgjikale:
  - Heqja e kancerit
  - Përcaktimi i stadi të kancerit
  - Nëse kanceri është përhapur, për të parë se ku është përhapur, çfarë madhësie kanë masat?
- Ndërhyrja kirurgjikale mund të bëhet duke përdorur një nga dy metodat:
  - Metoda e hapur (hapja e abdomenit me anë të një prerjeje të gjatë)
  - Metoda laparoskopike/robotike (Bëhen tre ose katër prerje të vogla për të futur një tub me një kamerë dhe mjete kirurgjikale)
- Ndërhyrja kirurgjikale mund të bëhet para ose pas kimioterapisë

## TERAPIA E TARGETUAR

- Një bar që targeton një veçori specifike ose unike të qelizës kancerogjene
- E disponueshme në situata specifike klinike

## IMUNOTERAPIA

- Një bar i krijuar për të rritur aktivitetin e sistemit imunitar
- E disponueshme në situata specifike klinike

## TERAPIA HORMONALE

- Një bar që ndalon prodhimin e një hormoni në trup ose që ndalon veprimin e një hormoni
- Një bar ose pilulë që merret nga goja
- Zakonisht jepet pas kimioterapisë dhe/ose ndërhyrjes kirurgjikale

## KIMIOTERAPIA

- Agjent kimik i zhvilluar për të vlarë qelizat kancerogjene.
- Mund të jepet në rrugë të ndryshme (p.sh. në rrugë intravenoze (intravenous, IV), nga goja, në kavitete).
- Mund të jepet me ose pa ndërhyrje kirurgjikale.
- Nëse synohet është tkurrja e tumorit kancerogjen, kimioterapia mund të jepet para ndërhyrjes kirurgjikale; kjo quhet kimioterapi *neoadjuvante*.
- Kimioterapia e dhënë pas ndërhyrjes kirurgjikale quhet *adjuvante*.
- Një trajtim është plani i vendosur i barnave që do të merren, i cili porositet nga një mjek për një pacient. Në përgjithësi, trajtimi jepet në mënyrë intravenoze ose me gjilpërë. Megjithatë pranohen edhe rrugë të tjera, në varësi të barit.
- Një cikël është numri i herëve që bari, ose kombinimi i barnave, do të merret. Për shembull, pacienti po merr ciklin nr. 2 nga 6 ciklet e kimioterapisë.
- Periudha e trajtimit është kohëzgjatja e administrimit të kimioterapisë. Periudha e trajtimit mund të ndahet në javë ose muaj, dhe në cikle. Shembull: Një pacient merr 4 cikle të "X" bari dhe 4 cikle të "Y" bari për "A" deri në "B" javë.

## TERAPIA ME RREZATIM

- Përdorimi i rrezeve X ose i llojeve të tjera të energjisë për të vlarë qelizat kancerogjene
- Zakonisht nuk përdoret për trajtimin e kancerit të vezores
- Mund të përdoret për të menaxhuar simptomat nëse kanceri është përhapur në pjesë të tjera të trupit (p.sh. në tru)